

mortore të Veliut në vreshtat e Miftaremit, ndërkaq vëllezërit Rustem dhe Mehdi Oruçi [komshinjtë e familjes Alisallahu] i mblihdhen mbetjet mortore të Muharremit dhe i varrosën në arën e Qazim Korenices. Me lejen e kryetarit të komunës, Anđelko Kolašinac, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Veliut në varrezat myslimane më 20.09.1998. Mbjetjet mortore të Muharremit janë zbuluar vetëm më 23.08.2000. Një ditë më vonë, familjarët e tij e kanë varrosur Muharremin në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata A.C, FDH-851; deklarata V.H, FDH-35292; deklarata R.A, FDH-35291.

Hatixhe (Qemajl Dërguti)

Hondozi

(25.03.1960, shqiptarë nga Rahoveci/Orahovac, amvise, katër fëmijë)

Hatixhja ka jetuar me bashkëshortin Rexhepin dhe fëmijët e tyre në qendër të qytetit, prapa xhamisë. Kur filloi beteja e **Rahovecit/Orahovac**, me ta së bashku ishin edhe e ëma dhe motra e Rexhepit. Kanë qëndruar në brendi të shtëpisë për tri ditë rresht. Ditën e hënë [20.07.1998], rreth orës 1:00, ata e braktisën shtëpinë. U nisën me kamion, të cilin e ngiste komshiu Shani Hoti dhe në të cilin ishin edhe familjarët e tij. Hatixhja ishte e ulur prapa me gratë dhe fëmijët. Kishte rënë terri i natës dhe ata shkolin rrugëve dytësore. Kur e kaluan një rrugë të vogël anësore [50 metra larg pikës së karburanteve *Jaha Petrol*], dhe vazhduan drejt fshatit Pataçan i Poshtëm/Donje Potočane, dikush hapi zjarr mbi ta. Plumbat e qëlluan Hatixhen në stomak. Burrat e bartën menjëherë në Drenoc/Drenovac. Më pas, dy ushtarët e UÇK-së e çuan në spitalin e fshatit Gajrak. Përderisa kalonin nëpër fshatin Zatriq/Zatrić, Hatixhja ndërroi jetë. Trupin e saj të pajetë e bartën së pari në xhami, e më pas, rreth orës 11:00, e varrosën në varrezat e Zatriqit/Zatrić. Pas përfundimit të luftës, më 16.06.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Hatixhes në varrezat e Rahovecit/Orahovac.

Burimet: deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata

N.N, FDH-879; deklarata R.H, FDH-35420;

Qemajl (Riza) Sylka

(26.04.1942, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, shofer në fabrikën 18 nëntor, pesë fëmijë)

Faik (Riza) Sylka

(21.01.1951, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, profesor muzike në shkollën Vuk Karadžić, tre fëmijë)

Haxhi (Shaip) Sharku

(17.07.1956, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, drejtor i shkollës fillore Isa Boletini, tre fëmijë)

Xhemajl (Mahmut) Rama

(28.02.1958, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tregtar, katër fëmijë)

Eqrem (Rexhep) Sylka

(15.04.1958, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, sekretar i shkollës fillore Isa Boletini, dy fëmijë)

Nesim (Rexhep) Sylka

(30.04.1962, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, një fëmijë)

Baki (Abaz) Shehu

(18.10.1963, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, moler, dy fëmijë)

Në mëngjesin e ditës së hënë, më 20.07.1998, forcat serbe filluan të shpërndaheshin në lagjet *Sylka*, *Sharku*, *Mullaabazi*, që gjenden në vazhdimësi të Shtëpisë së Zjarrfikësve, në drejtim të godinës së komunës [Rahovec/Orahovac]. Aty gjendej edhe shtëpia e Selami Shehut, djalit të shehut Muhedin. Disa qindra shqiptarë ishin strehuar në Teqenë e sheh Muhedit, ndërkaq një grup, në të cilin ishin Haxhi Sharku, vëllezërit Faiku dhe Qemajli, vëllezërit Eqremi dhe Nesimi, si dhe Xhemajl Rama, që të gjithë me familjet e veta, u strehuan në oborrin e shtëpisë së re të Selamiut, në afërsi të Shtëpisë së Zjarrfikësve. Një natë më parë, në të njëjtin vend ishte strehuar edhe Baki Shehu me familje. Gratë dhe fëmijët ishin strehuar në bodrumin prapa shtëpisë, ndërkaq burrat në bodrumin tjetër, i cili gjendej nga ana e përparme të shtëpisë. Rreth orës 12:00, policët depërtuan në oborr me autobindë. Në atë çast, në oborr gjendeshin Haxhiu, Faiku, Qemajli, Eqremi, Nesimi, Xhemajli dhe Bakiu. Policët u urdhëruan burrave që